REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NY. 523 Prot.
Dt. 23.03.2023

BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 12 DATE 23/03/2023

PËR

"MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026".

Në mbështetje të nenit 34, pikat 5, te ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", të, Udhëzimit te MFE nr.23, dt.30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësive të vetqeverisjes vendore", i ndryshuar, Udhëzimit te MFE nr.06, datë 28.02.2023, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2024-2026", Vendimit të Keshillit të Bashkisë nr.74, datë 21.12.2022, "Për miratimin e kalendarit të PBA 2024-2026", Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.08, datë 28.02.2023, "Për miratimin e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave, në kuadër të përgatitjes së PBA2024-2026", Vendimit nr.02, datë 17.01.2023, të Kryetarit të Bashkise "Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve, në kuadër të PBA 2024-2026", Shkresës së Këshillit të Bashkisë nr.482 prot., datë 15.03.2023, "Rezultatet e sontazhit të prioritetevetë komunitetit të Bashkisë Dropull", në mbledhjen e datës 23.03.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e Tavaneve Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026", (Sipas tabelës bashkangjitur).

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij Vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr.139/2015"Për Vetëqeverisjen Vendore").

KRYETAR
Donika BAUÇI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DROPULL

Bazuar në burimet e mësiperme të të ardhurave, si edhe ne Shkresën e Këshillit të Bashkisë nr.482 prot., datë 15.03.2023, "Rezultatet e sontazhit të prioriteteve të komunitetit të Bashkisë Dropull", Grupi për Menaxhim Strategjik, ka diskutuar dhe ka vendosur tí paraqesë Këshillit Bashkiak, Tavanet Përgatitore, që janë kufiri më i sipërm i shumes totale te parave, që mund të shpenzohen ose te planifikohen për tu shpenzuar për sejcilin nga katërmbedhjetë programet (funksionet) buxhetore, duke i dhënë përparësi në krahasim me buxhetin e vitit 2023, rrugeve rurale, shërbimit te pastrimit dhe trashëgimisë kulturore e turizmit. Nëpërmjet tavaneve të shpenzimeve të programeve buxhetore, Bashkia bën të mundur realizimin e qellimeve, objektivave, aktiviteteve dhe produkteve që caktojnë GMS dhe EMP-të.

Në kuadër të PBA 2024-2026, objektivat dhe sfidat me të cilat përballet Bashkia jonë do të jene:

1- **të sigurohet furnizimi me ujë pa ndërprerje për 95% të popullsisë brënda vitit të parë të PBA 2024-2026,** nëpërmjet vënies në efiçensë të investimeve të realizuara, përfundimit të projekteve në vazhdim në programin 06370 (furnizimi me ujë).
2- **Rritja e aksesueshmerisë dhe integrimi territorial** si në nivel makro dhe atë mikro, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së veprave te artit, si urat , rrugët, përmiresimi i menaxhimit të reziqeve natyrore.
3- **rruajtja e jetës dhe shëndetit te banorëve, sidomos e kategorive të rezikuara**; zgjdhja e problemeve të përditshmërisë dhe ato të nevojave bazë të komunitetit, për shkak të vazhdimit të efekteve të krizës energjetike dhe inflacionit në rritje.
4- **Garantimi i sigurisë publike** (ruajtjen nga vjedhjet dhe dëmtimet të pronës private e publike), mbarëvajtjes se marrëdhënieve në komunitet, duke krijuar një klime tejet miqësore për biznesin, emigrantët dhe turizmin, sidomos kjo në zonat e thella në Njësinë Administrative Dropull i Siperm dhe gjithë Njësine Administrative Pogon.
5- **Të sigurojë kushte jetese dinjitoze për moshën e tretë**, për mbështetjen e shtresave në nevojë, për akses në sherbimet e Bashkisë, sidomos të fshatrave të thella, ndërtimin dhe pajisjen e një qëndre ditore dhe rezidenciale për të moshuarit, si dhe përfitimet nga programet e strehimit social.
6- **Mbrojtja e territorit**, rehabilitimi i veprave infrastrukturore dhe historike, menaxhimi i burimeve ujore, përmirësimi i menaxhimit të reziqeve natyrore, [illegible] hartimi i planeve të